

**Takimi i gjashtëmbëdhjetë koordinues midis trojkës së Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Sekretariatit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC) dhe Bashkimit Evropian (BE)**

Sarajevë, 15 tetor 2014



Takimi me përfaqësues të trojkës së SEECP-së: Shqipëria, Rumania dhe Bullgaria, sekretariatit të RCC-së dhe BE-së, u bashkë-kryesua nga Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së dhe Koordinatorit Kombëtar të SEECP/RCC, Kryetar i Sekretariatit të SEECP-së në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në emër të Kryesisë shqiptare të SEECP-së.

Gjatë takimit u informua mbi aktivitetet kryesore të lidhura me prioritetet e Kryesisë shqiptare të SEECP-së për periudhën 2014-2015. Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së përsëriti mbështetjen e plotë dhe gatishmërinë e kësaj organizate për të kontribuar në suksesin e Kryesisë shqiptare të SEECP-së.

Ai vuri në dukje se sinergjia strategjike dhe koordinimi midis RCC-së dhe Kryesisë shqiptare të SEECP-së ka një rol të pa zëvendësueshëm në koordinim e procesit të bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore. Në këtë kontekst, ai theksoi rëndësinë e vizitave të Kryesisë së SEECP-së në Sekretariatit të RCC-së dhe konsultimeve të SP të RCC me MPJ-në e Shqipërisë, gjë që rezultoi në harmonizimin e përpjekjeve të RCC-së dhe Kryesisë së SEECP-së për implementimin e kalendarit të aktiviteteve të Kryesisë. Ai nënvizoi se takimi informal i Ministrave të Jashtëm të vendeve pjesëmarrëse në SEECP, mbajtur nën Kryesinë shqiptare të SEECP-së më 25 shtator 2014, në Nju Jork, ishte kontribut për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe integritimit evropian.



Kryesia shqiptare e SEECP-së nënvizoi bashkëpunimin e shkëlqyer me sekretariatit e RCC-së, dhe rolin e SEECP-së si forumin kryesor politik të bashkëpunimit në Evropën Juglindore. Kryesia do të drejtohet nga parimet e Kartës së SEECP-së dhe deklarata e Samitit dhe do të reflektojë prioritetet e politikës së jashtme të Shqipërisë, duke marre në konsiderate bashkëpunimin rajonal dhe fqinjësinë e mire, si shtylla dhe garanci për prosperitet dhe qëndrueshmëri. Ajo është e zotuar për bashkëpunim me EC, dhe sidomos me Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal, si krahu operacional i SEECP-së.

Kryesia shqiptare e SEECP-së kërkoi mbështetjen dhe asistencën e të gjithë koordinatorëve të RCC-së dhe SEECP –së për të siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të vendeve të tyre në aktivitetet që do mbahen në Tiranë.

Kryesia paraardhëse Rumune e SEECP-së përshëndeti Kryesinë shqiptare, sidomos aktivitetet e planifikuara dhe vazhdimësinë në punën me Sekretariatit e RCC-së, veçanërisht në Kapitujt 23 dhe 24 mbi shtetin ligjor, liritë themelore dhe luftën kundër korrupsionit.

Përfaqësuesi i BE-së falenderoi Kryesinë Rumune të SEECP-së për punën e bërë dhe shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe mbështetje të Kryesisë shqiptare të SEECP-së.

#### **Takimi arriti përfundimet e mëposhtme:**

1. U pohua dhe një herë mbështetja për kalendarin e aktiviteteve të Kryesisë shqiptare të SEECP-së dhe u shpreh bindja se rezultatet e dëshiruara do të kontribuojnë në progresin e procesit të integritetit Evropian dhe Euroatlantik.
2. U vu në dukje rëndësia e një bashkëpunimi më të madh midis Nismës Adriatiko-Joniane dhe strategjisë së BE-së për Rajonin e Danubit.
3. Mirëpriti iniciativën për forcimin e bashkëpunimit midis Sekretariatit të RCC-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe rajonale, sidomos me Forumin Ekonomik të Vjenës dhe Fondacionin për Trajnim të BE-së.